



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.02/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses/propozueses të masës së sigurimit A.Z. nga Tirana Rr....-Shqipëri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Blerim Mazreku nga Prizreni, kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Sh.B. D... shpk nga Peja Rr....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokate Vjosa Shkodra nga Prishtina, për shkak të propozimit për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit KE.nr.1271/22 datës 08.11.2022 të Gjykatës Komerciale - Departamenti për çështje ekonomike, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.01.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurit/kundërshtarit Sh.B. D... shpk nga Peja, PRISHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Departamenti për çështje ekonomike K.E.nr.1271/22 datës 08.11.2022, dhe Lënda kthehet, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktvendimin e atakuar, KE.nr.1271/22 datës 08.11.2022, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit, e ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit A.Z. nga Tirana Rr.....-Shqipëri, i paraqitur me datë 25.05.2022 kundër kundërshtarit të sigurimit Sh.B. D... shpk nga Peja, në pikën 2, ka Caktuar masës e sigurimit ndaj kundërshtarit të masës së sigurimit Sh.B. D... shpk nga Peja, ashtu që të njëjtit i ndalohet shitja në çfarëdo forme e paketës didaktike “mësoj si nxënës, luaj si fëmijë” për klasën përgatitore dhe e tekstit shkollor Gjuhë shqipe 2,A dhe 2B, për klasën e dytë të arsimit fillor, të cilat janë botuar nga Sh.B. D... shpk nga Peja, me qëllim të përdorimit të tyre për klasat e sipërpërmendura, deri në një vendim tjetër të gjykatës, pika 3 Refuzohet pjesërisht propozimi i propozuesit të masës së sigurimit për masën paraprake me çka ka kërkuar që ti bllokohen llogarit bankare të kundërshtarit të masës Sh.B. D... shok, pika 4 Një kopje e këtij vendimi i ekspozohet për njoftim Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit për vendimin e gjykatës.

Kundër këtij Aktvendimi ankimor, ka parashtruar ankesë kundërshtari i propozimit paditurit/kundërshtarit Sh.B. D... shpk nga Peja, me përfaqësuese të autorizuar Vjosa Shkodra avokate nga Prishtina, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i goditur në dispozitivin I dhe II, të cilat pika I dhe II sipas këtij aktvendimi ndryshohen si vijon: Refuzohet propozimi i propozueses A.Z. për caktimin e masës së sigurimit si e pabazuar në tërsi, Lejohet shitja e paketës didaktike “mësoj si nxënës, luaj si fëmijë” për klasën përgaditore dhe tekstet shkollore Gjuha Shqipe 2A dhe 2B për klasën e dytë të arsimit fillor, të cilat janë botuar nga Sh.B. D... shpk nga Peja, me qëllim të vazhdimit të përdorimit të këtyre librave për nxënësit, në alternativë të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet dispozitivi I dhe II i aktvendimit të goditur dhe të kthehet çështja në procedim të sërishëm në shkallë të parë.

Në arsyetim të ankesës theksohet se aktvendimi i shkallës së parë është i përbërë me shkelje të dispozitave të LPK-së, neni 5. Në seancën e shqyrtimit përgatitor të mbajtur në Departamentin Ekonomik të Gjykatës Themelore në Prishtinë me datën 21.01.2022 paditësi ka qenë i obliguar që të prezantoj prova shtesë për të saktësuar apo precizuar pretendimet e saj dhe njëkohësisht këto shkresa shtesë të ndahen edhe me të paditurën me qëllim që pastaj të bëhet edhe përgjigja në padi. E informojmë gjykatën se këto prova shtesë nuk i kemi pranuar. Në seancën e datës 24.10.2022 kundërpropozuesja në mungese të shkresave shtesë nuk pati mundësi as ti pranoj, lexoj as të deklarohet rreth tyre e që është shkelje e nenit 5 të LPK-së. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 7 të LPK-së. Kundërpropozuesja në asnjë mënyrë nuk ka bërë shkelje ligjore sepse së pari e ka njohur kontributin dhe të drejtën e autorit sipas ligjit dhe i ka ofruar kompensim në proporcion me bashkëautorët e tjerë sipas ligjit për të drejtat e autorit. Në asnjë rrethanë bazuar në shkresat e lëndës dhe deklaratave në seancë nuk arsyetohet fakti se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit palës kundërshtare do ti pamundësohej spovështirësohej realizimi i kërkesës, nuk janë plotësuar dy kushtet ligjore në mënyrë kumulative. Ligji për të Drejtat e Autorit neni 15, nuk e definon fare autorin kryesor me kontribut më shumë apo më pak, meqë të gjithë autorët kanë kontribuar në librat objekt i këtij kontesti.

Në përgjigje në ankesë i autorizuari i propozueses së masës së sigurimit, i propozon Dhomës së Shkallës së Dytë, që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e paditurit-kundërshtarit të masës së sigurimit dhe të vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Departamenti për çështje ekonomike K.E.nr.1271/22 datës 08.11.2022. Në rast se pala e paditur nuk ka paraqit ankesën brenda afatit i propozojmë kësaj gjykate që të marr aktvendim për hudhje të pas afatshme të ankesës së palës së paditur. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt dhe ligjshëm dhe ka zbatuar drejt Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili rregullon edhe masat e sigurisë në këtë kontest. Nuk qëndron pretendimi palës së paditur se nuk i janë dorëzuar shkresat, Parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që ti argumentoj pretendimet e saj se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh, se duke vepruar sipas propozimit të propozuesit të masës së sigurimit, A.Z. nga Tirana Rr.,...-Shqipëri, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të mbajtur me datën 24.10.2022, Dhomat e shkallës së parë, me Aktvendimin e atakuar, KE.nr.1271/22 datës 08.11.2022, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit, e ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin e propozueses së masës së sigurimit A.Z. nga Tirana Rr.,...-Shqipëri, i paraqitur me datë 25.05.2022 kundër kundërshtarit të sigurimit Sh.B. D... shpk nga Peja, në pikën 2, ka Caktuar masën e sigurimit ndaj kundërshtarit të masës së sigurimit Sh.B. D... shpk nga Peja, ashtu që të njëjtit i ndalohej shitja në çfarëdo forme e paketës didaktike “mësoj si nxënës, luaj si fëmijë” për klasën përgatitore dhe e tekstit shkollor Gjuhë shqipe 2,A dhe 2B, për klasën e dytë të arsimit fillor, të cilat janë botuar nga Sh.B. D... shpk nga Peja, me qëllim të përdorimit të tyre për klasat e sipërpërmendura, deri në një vendim tjetër të gjykatës, pika 3 Refuzohet pjesërisht propozimi i propozuesit të masës së sigurimit për masën paraprake me çka ka kërkuar që ti bllokohen llogarit bankare të kundërshtarit të masës Sh.B. D... shok, pika 4 Një kopje e këtij vendimi i eksponohet për njoftim Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit për vendimin e gjykatës.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë referohet në dispozitën e nenit 297 të LPK-së, se propozuesi i masës ka ofruar prova bindëse lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tij, me të cilat vërtetohen pretendimet e tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Autorësia e propozueses nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse. Palët nuk kanë formalizuar marrëdhënien në mes tyre me një kontratë me shkrim e që në mungesë të së cilës, propozuesja nuk ka pranuar kompensim asnjëherë dhe në asnjë formë. Gjykata mori për bazë faktin se Sh.B. jo vetëm ka shitur në tri vitet e fundit kompilacionet nga paketa didaktike por e njëjta vazhdon të veprojë në të njëjtën formë, me veprime të këtilla, kundërpropozuesja i shkakton dëm të konsiderueshëm në vazhdimësi bashkëautores së botimeve, me faktin se nuk i ka dhënë asnjë lloj kompensimi për punën e kryer.

Në këtë gjendje të çështjes juridike, Dhoma e Shkallës së Dytë, pranon pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në seancat dëgjimore të mbajtura më datën 21.01.2022 dhe 24.10.2022, nuk i ka dhënë palës tjetër ndërgjyqëse palës së paditur-kundërpropozueses, të gjitha shkresat shtesë që i ka paraqit paditësja-propozuesja para gjykatës, ashtu që të paditurës ti mundësohet deklarimi për kërkesat dhe pretendimet e palës paditëse. Këtë fakt Kolegji e vlerësoi nga shkresat e lëndës, thirjet e seancave gjyqësore dhe procesverbalet e seancave gjyqësore, se nuk ekzistojnë prova se pala e paditur i ka pranuar këto shkresa shtesë nga gjykata apo pala paditëse. Prandaj Kolegji vlerësoi se në këtë rast nga gjykata e shkallës së parë nuk është respektuar dispozita e nenit 5 dhe 7 të LPK-së, që parasheh:

Neni 5. Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.

Neni 7. Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së dytë, vlerësoi se në aktvendimin e atakuar, nuk janë dhënë arsye dhe dëshmi të mjaftueshme për caktimin e masës së sigurimit.

Sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.* Nga kjo dispozitë rrjedh se masa e sigurimit mund të caktohet për parandalimin e veprimeve të dëmshme të kundërshtarit të sigurimit.

Arsyetimi i aktvendimit të atakuar nuk përmban arsye të mjaftueshme se, si është plotësuar kushti i dytë, nga pika b) e dispozitës së sipërcekur, pasi në rastin konkret nuk është sqaruar se a kemi të bëjmë me një kontribut ndaras në hartimin e librave nga paditësja-propozuesja, dhe në anën tjetër gjykata në arsyetim të vendimit ankimor, nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se dëmi i shkaktuar paditëses do të pamundësonte realizimin e kërkesës së paditëses, nga Shtëpia Botuese, e cila boton librat për interes publik.

Kolegji tani për tani nuk mund të konstatoj një gjendje faktike për të vlerësuar se është argumentuar mjaftueshëm ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit, do të pamundësonte ose vështirësonte realizimin e kërkesës së propozueses, që parashihet me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së.

Shkeljet e tilla në mos vlerësimin e të gjitha pretendimeve konkrete në caktimin e masës së sigurimit, përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të prishet. Kolegji gjithashtu shqyrtoi pretendimet ne përgjigje në ankesë të paditëses, lidhur me afatshmërin e ankesës, dhe nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa e paditurit është paraqitur brenda afatit ligjor prej 7 ditëve, provë: Fletë-kthesa dt.13.12.2022 dhe data e vulës së Gjykatës Komerciale, 20.12.2022 në Ankesë.

Dhoma e Shkallës së Parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitoj të gjitha të metat të cekura më lartë, të evitoj të metat ligjore nga neni 5 dhe 7 të LPK-së, ashtu që në seancën dëgjimore palës së paditur ti dorëzohen të gjitha provat shtesë që i ka paraqit pala paditëse, dhe t'iu mundësohet palëve ndërgjyqëse, që të deklarohen rreth kërkesave dhe pretendimeve të palës

kundërshtare, në drejtim të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit. Duke marrë për bazë edhe vërejtjet e lartcekura, në plotësimin e kushteve ligjore nga neni 297.1 të LPK-së, Dhoma e shkallës së parë pas vërtetimit të gjendjes faktike të sjell vendim të drejt dhe të ligjshëm ashtu që propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ta trajtoj dhe vendos në raport me pretendimet dhe provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.shk.II.nr.02/2023 datë 17.01.2023

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha